



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVO
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Udhëzime për plotësimin dhe dorëzimin e aplikacionit për licencë bankare

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
Departamenti për Licencim dhe Standardizim
Garibaldi 33, 10000 Prishtinë
Republika e Kosovës

Përmbajtja

1. Dorëzimi i aplikacionit për licencë bankare	3
2. Kriteret për vlerësimin e kandidatëve	3
3. Plotësimi i një aplikacioni.....	4
4. Procedimi i aplikacionit	4
5. Letra e sigurisë / komoditetit	6
6. Shënime udhëzuese për përmbajtjen e planit të biznesit	7
7. BQK-ja përgjithësisht kundërshton kapitalin e ngritur nga borxhi në një banke të re	9
8. Informacionet e projeksioneve financiare.....	9

1. Dorëzimi i aplikacionit për licencë bankare

Secili aplikues duhet të vlerësojë nëse modeli i tij i biznesit të propozuar të institucionit financiar:

- kërkon një licencë bankare (përfshirë edhe përmbushjen e definicionit “bankë” sipas Ligjit nr. 04/L-093 Për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare);
- të jetë në pajtueshmëri me kërkesat e BQK-së; dhe
- të jetë në pajtueshmëri me kërkesat që duhet të respektohen nga banka / institucionet financiare në baza të vazhdueshme.

Kur ky vlerësim të jetë plotësuar atëherë aplikuesi duhet të aranzhojë një takim preliminar me Departamentin për Licencim dhe Standardizim të BQK-së në numrat e telefonit +381 (0) 38 / 222 – 055 lokali 303.

BQK-ja mirëpret aplikacionet për licencë bankare ku banka e propozuar/institucion financiar ('aplikuesi ') mund të plotësojnë kriteret e BQK-së siç është përcaktuar në aplikacionin për licencë bankare për bankat vendore nga Departamenti për Licencim dhe Standardizim të publikuara në ueb-faqen BQK-së: www.bqk-kos.org tek Aplikacionet - Shtojca 1.

Aplikuesi duhet të jetë i njohur me të gjitha dispozitat ligjore të zbatueshme për të gjitha bankat/institucionet financiare në Kosovë. Aplikuesi duhet ta kuptojë qëllimin dhe zbatimin e të gjitha rregulloreve dhe kërkesave të reja të lëshuara nga BQK-ja, detajet e të cilave janë të publikuara nën rregulloret e bankave në ueb-faqen të BQK-së: www.bqk-kos.org.

2. Kriteret për vlerësimin e kandidatëve/aplikantëve

Në bazë të nenit 7 të Ligjit për bankat një aplikacion për licencë duhet të jetë në formë të tillë ashtu siç përcaktohet nga BQK-ja dhe duhet të përmbajë të dhëna ashtu siç mund të përcaktohen kohë pas kohe nga BQK-ja.

Fushat kryesore që konsiderohen nga BQK-ja në vlerësimin e aplikimeve për licencë bankare përfshijnë:

- Struktura e pronësisë;
- Objektivat e aplikuesit dhe aktivitetet e propozuara;
- Strukturën ligjore (statutin dhe aktet e themelimit);
- Planin e biznesit (duke përfshirë strukturën organizative, marrëveshjet e qeverisjes së korporatës, personelin kryesor, departamentet, etj.);
- Mbikëqyrjen e riskut (p.sh. auditimi, pajtueshmëria, menaxhimin e rrezikut, kreditë, likuiditeti, tregu, operacionet, kontrollin financiar, kontrollat e brendshme, etj.);
- Projektionet e kapitalit;
- Projektionet financiare;
- Informacione rreth bankës amë/grupit të aplikuesit;
- Mbikëqyrja e konsoliduar e bankës amë/grupit; dhe
- Të tjera sipas nevojës.

Kërkesat e BQK-së në lidhje me secilin nga këta titujve më sipër, gjenden të detajuara në faqen e internetit të BQK-së (www.bqk-kos.org) tek aplikacionet në Shtojcën 3 *'Lista kontrolluese për plotësimin dhe dorëzimin e aplikacioneve për licencë bankare'* ('lista kontrolluese').

3. Plotësimi i një aplikacioni

Para plotësimit të një aplikacioni, BQK-ja kërkon që të gjithë organizatorët të takohen ose me Guvernatorin apo Zëvendësguvernatorin për Mbikëqyrje Financiare dhe Drejtorin e Departamentit për Licencim dhe Standardizim. Gjatë takimit paraprak, anëtari i grupit organizativ duhet të identifikohet si zëdhënës, për të përfaqësuar organizatorët në të gjitha kontaktet pasuese me BQK-në. BQK'ja do të pranojë aplikacionet për licencë bankare pas takimi të zhvilluar me organizatorët.

Pas takimit paraprak, kërkesat informative të përshkruara në listën kontrolluese duhet t'i ofrohen BQK-së në mbështetje të aplikacionit për licencë bankare. Të gjitha informacionet e listuara duhet patjetër të ofrohen në mënyrë që ta përbëjë një aplikacion të kompletuar. Nuk do të thotë që lista kontrolluese t'i referohet të gjitha informacioneve përkatëse lidhur me një aplikim për licencë bankare dhe aplikuesi duhet ta zgjerojë informacionin e kërkuar, aty ku është e nevojshme, sipas natyrës specifike të biznesit të propozuar. Lista kontrolluese duhet të plotësohet dhe të dorëzohet së bashku me të gjithë dokumentacionin përkatës dhe mbështetës.

Aplikanti nëse është bankë e huaj para dorëzimit të aplikacionit në BQK gjithësesi duhet t'i bëjë një kërkesë mbikëqyrësit të konsoliduar të aplikuesit, për të marrë pëlqimin e themelimit të bankës në Kosovës.

BQK-ja nuk do të fillojë procesin e shqyrtimit të aplikacionit, deri sa të pranojë aplikacionin me të gjithë dokumentacionin përkatës dhe mbështetës.

4. Procesimi i aplikacionit

BQK-ja do ta shqyrtojë aplikacionin dhe dokumentacionin e bashkëngjitur. Pas këtij shqyrtimi, BQK-ja do të lëshojë komente këshilluese për aplikuesin rreth ndonjë informacioni apo sqarimi që kërkohet lidhur me cilindo aspekt të aplikacionit.

Aplikuesi duhet ta njoftojë BQK-në kur planifikohet apo paraqitet ndonjë ndryshim i rëndësishëm. Personeli i licencimit i BQK-së do të njoftohet për ndonjë seri të ndryshimeve që paraqiten gjatë periudhës së zgjatur kohore. Korigjimet e rëndësishme të aplikacionit përveç atyre të nevojshme, për të bërë aplikacionin teknikisht të kompletuar, mund ta shtyjë BQK-në të konkludojë se aplikacioni origjinal është i vjetruar. Në raste të tilla, aplikacioni fillestar do të konsiderohet i tërhequr dhe kërkohet aplikim i ri së bashku me pagesën e nevojshme për aplikim. Nëse nuk është i nevojshëm aplikacioni i ri, por korigjimet apo ndryshimet rezultojnë në shqyrtim shtesë të konsiderueshëm dhe për procedim nga BQK-ja, mund të kërkohet një tarifë shtesë.

Personeli i licencimit shqyrton aplikacionin për saktësinë dhe kompletimin. Korigjimet e vogla do të trajtohen përmes korrespondencës së emailave. Nevoja për korigjime të shumta teknike mund të shkaktojë kthimin e aplikacionit. Aplikuesve në përgjithësi i jepet një mundësi për të bërë korigjime

teknike. Aplikimi mund të konsiderohet si i tërhequr nëse korrigeimet e duhura nuk janë bërë brenda një kohe të arsyeshme. Pagesat e bëra gjatë aplikimit nuk kthehen. Ridorëzimi i mëvonshëm do të kërkojë një aplikacion të ri, si dhe pagesën e nevojshme për dorëzimin e aplikacionit. Departamenti i licencimit do të zhvillojë një takim për çdo informacion shtesë apo ndonjë ndryshim në lidhje me kërkesën. Ky takim do të regjistrohet në procesverbalin e dosjes së aplikuesit.

Pasi aplikacioni është kompletuar teknikisht, personeli i licencimit do të procesojë me një shqyrtim dhe analizë më të thellë të aplikacionit.

Koha e përgjithshme për licencim varet nga:

- koha që e merr aplikuesi për t'u përgjigjur në komenteve në çështjet e ngritura;
- kualiteti i përgjigjeve të pranuar, duke iu adresuar të gjitha çështjeve të ngritura;
- çdo ndryshimi që bëhet nga aplikuesi gjatë procesit të aplikimit; dhe
- koha e shpenzuar nga çdo palë e tretë përkatëse për t'iu përgjigjur çështjeve në lidhje me aplikimin

BQK-ja do të kërkojë referencat dhe mendimet e nevojshme nga autoritetet përkatëse mbikëqyrëse vendore. Kërkesa mund të parashtrohet edhe tek autoritetet mbikëqyrëse jashtë Kosovës në juridiksionin e të cilit banka/grupi amë i aplikuesi ka një prani të konsiderueshme.

Vlerësimi do të bazohet kryesisht në informatat e përmbajtura në aplikacion dhe në informatat tjera që janë në dispozicion të BQK-së, si rezultatet e aktiviteteve të saj mbikëqyrëse. Personeli i licencimit do t'i shqyrtojë kualifikimet dhe kushtet financiare të aplikuesit, kryeshefit ekzekutiv të propozuar dhe menaxhmentit të lartë. Kriteret e mëposhtme duhet të merren në konsideratë:

- Drejtorët e propozuar duhet të përmbushin të gjitha kërkesat ligjore.
- Drejtorët e propozuar duhet të kenë kualifikim të duhur profesional dhe përvojë bankare, financiare apo biznesore.
- Drejtorët e propozuar kanë njohuri në lidhje me tregun dhe shërbimet që duhet të ofrohen.
- Drejtorët e propozuar dhe kryeshefi ekzekutiv janë të njohur me procesin e aplikimit dhe do të marrin pjesë në mënyrë aktive në organizimin dhe operimin e bankës.
- Kryeshefi i propozuar duhet të ketë përvojën e përshtatshme për ndjekjen e planit të ri të biznesit të bankës, dhe të jetë i njoftuar gjerësisht për planin e biznesit.
- Aksionarët kryesorë kanë forcë financiare për të mbështetur investimet e tyre.
- Aksionarët ,drejtorët e propozuar, kryeshefi ekzekutiv dhe menaxherët e tjerë janë persona me integritet të lartë.
- Menaxhmenti i bankës duhet të operojë si një konkurrent i qëndrueshëm dhe i sigurt në tregun në të cilin planifikon të shërbejë.
- Aftësitë dhe kualifikimet e menaxhmentit të propozuar.
- Shkalla në të cilën aftësitë e tilla të menaxhimit dhe kualifikimet do t'i përmbushin nevojat e bankës së re.

Personeli i licencimit do të kryejë verifikimin e historikut të gjithë organizatorëve, kryeshefit ekzekutiv të propozuar, ndonjë menaxheri tjetër të lartë, drejtorëve dhe aksionarëve kryesorë të identifikuar në aplikacion. Verifikimi i historikut jep informata mbi kompetencën, përvojën, integritetin dhe aftësinë financiare të çdo personi të përmendur në aplikacion dhe japin një përcaktim të pavarur për saktësinë dhe

tërësinë e informacionit të paraqitur. Informacionet e marra nga BQK-ja për hetimin për historikun mund të ndahen me agjencione, institucionet e tjera financiare rregullatore. Departamenti për licencim dhe standardizim mund të kërkojë informacion shtesë për të bërë një përcaktim të pavarur për saktësinë dhe plotësinë e çfarëdo informacioni që përmban një aplikacion për licencë.

Kur procesi i shqyrtimit të jetë kryer me sukses, personeli i licencimit do të përgatitë një raport rekomandimi me një opinion mbi aplikimin. Ky raport do t'i paraqitet së pari Zëvendës Guvernatorit për mbikëqyrje financiare, mandej edhe Bordit Ekzekutiv të BQK-së për vendimmarrje.

SHËNIM: Një licencë do të jepet vetëm atëherë kur BQK-ja është e kënaqur me plotësimin e të gjitha kushteve dhe kërkesave nga aplikuesi.

Bordi Ekzekutiv i BQK-së do të marrë një vendim duke u bazuar në autorizimin që i jep legjislacioni në fuqi. Nëse BQK-ja nuk ka kundërshtime ndaj aplikacionit për të themeluar një bankë, ajo nxjerr vendim për miratimin paraprak të kërkesës për licencë.

SHËNIM: Aplikuesi mund të fillojë organizimin e bankës sapo ata të marrin njoftimin nga BQK-ja për miratim paraprak. Megjithatë, biznesi i aktivitetit bankar nuk mund të fillojë deri sa të jetë lëshuar një licencë përfundimisht.

5. Letra e mbështetjes

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës do të presë që banka amë e aplikuesit për licencë që të dorëzojë një letër mbështetëse, drejtuar BQK-së të formuluar si në formën e mëposhtme: (Nëse licenca është siguruar, BQK ja mund të kërkojë nga banka amë që të freskojë letrën kohë pas kohe.)

“Ne ju shkruajmë për të konfirmuar se [emri i institucionit të propozuar bankar] është një subjekt i varur në pronësi të plotë të [emri i bankës amë]. Struktura e bashkangjitur e strukturës së grupit tregon zinxhirin e pronësisë në mes [emri i bankës amë] dhe [emri i institucionit të propozuar bankar].

Është në interesin komercial të [emri i bankës amë] se [emri i institucionit të propozuar bankar] vazhdon të përmbushë gjatë gjithë kohës detyrimet dhe obligimet e saja që ka ndaj klientëve.

Prandaj ne e njohim përgjegjësinë mbi të dhe obligimet juridiket cilat mund të ekzistojnë për të mbrojtur stabilitetin financiar të saj dhe të sigurohemi se ajo është gjithmonë në gjendje të përmbushë detyrimet e saj dhe konfirmojmë se ne do të përmbushim këtë përgjegjësi.

6. Shënime udhëzuese për përmbajtjen e planit të biznesit

6.1. Plani i biznesit

Duhet të jetë një plan biznesi trevjeçar i cili ndjek formatin e shënuar më poshtë dhe të mbështetet me një letër autorizim nga kompania.

Bankat, si çdo organizatë, duhet të kenë një plan biznesi/strategjik i cili përcakton objektivat dhe strategjitë e bordit të drejtorëve. Plani duhet të ofrojë prioritetet themelore dhe udhëzimet për menaxhimin e brendshëm dhe duhet të aprovohet nga bordi i drejtorëve. Plani nuk duhet të jetë një dokument statik, por duhet të lejojë ndryshim dhe fleksibilitet siç mund të kërkojnë rrethanat. BQK-ja do të shqyrtojë planin e biznesit/strategjik të institucionit në ekzaminimet periodike, ose kur ngrihen çështje të tjera rregullative.

Aplikuesi/organizatori që aplikon për licencë bankare duhet të paraqes për shqyrtim një plan biznesi të detajuar, si pjesë e procesit të aplikimit. Nga një institucion mund të kërkohet që të paraqesë një plan biznesi të ndryshuar kur themelohet një degë ose për të bërë një ndryshim të rëndësishëm në operim.

Më poshtë gjendet formati i sugjeruar për përgatitjen e një plani biznesi:

Plani i biznesit duhet të identifikojë tregun (tregjet) e propozuar që do të shërbehen, produktet dhe shërbimet që do të ofrohen, parashikimet e profitabilitet, mjaftueshmëria e kapitalit dhe burimet menaxheriale si dhe mundësitë. Plani duhet të përfshijë parashikimet operacionale për të paktën tri vite duke përdorur formatin në faqen e internetit të BQK-së (bqk-kos.org) tek Aplikacionet në Shtojcën D - pro forma e projeksioneve financiare.

Plani i biznesit duhet të paraqesë të dhënat që pasqyrojnë gjendjen ekonomike reale të tregut të përcaktuar dhe trajton ndryshimet statusore dhe rregullative, të cilat mund të ndikojnë në veprimtarinë e bankës së propozuar..

Plani i biznesit duhet të përmbajë informata të mjaftueshme për të treguar se banka ka propozuar supozime të arsyeshme dhe realiste. Në lidhje me këtë, një listë e detajuar e të gjitha supozimeve të përdorura në përgatitjen e planit operativ duhet të jetë e bashkëngjitur gjatë dorëzimit (p.sh., një analizë e margjinave dhe koston e fondeve). Pasi që një aplikim i plotë teknikisht të jetë dorëzuar, BQK-ja nuk do të kërkojë informata shtesë përveç nëse lindin shqetësimet që nuk janë adresuar arsyeshëm siç është pritur nga aplikuesi.

Prandaj, organizatorët duhet të sigurojnë që projeksionet financiare janë të mbështetura mirë si dhe qëllimet dhe objektivat janë specifike dhe të përcaktuara siç duhet në paraqitjen fillestare.

SHËNIM: Personeli i licencimit do të shqyrtojë planin e biznesit për të përcaktuar nëse ai është i kënaqshëm. Nëse mangësitë e gjetura janë të rëndësishme, plani i biznesit do të duhet të ndryshohet në mënyrë për ta bërë atë të pranueshme.

6.2. Analiza e tregut

Analiza e tregut që do të shërbehet. Përshkrimi i tregut në të cilën ju prisni për të ofruar shërbime në lidhje me karakteristikat ekonomike, p.sh., madhësia, të hyrat dhe industria dhe modelet e banimit.

Përfshijnë ndryshimet e parashikuara në treg, faktorët që ndikojnë këto ndryshime dhe efekti që do të ketë në bankën e propozuar. Kur është e nevojshme për marrjen e vendimeve në biznes, përshkruaj dallimet në tregjet e produktit që do të shërbehen për shembull, ndryshimet në tregun e depozitave dhe kreditit. Analiza do të bazohet në përdorimin e të dhënave më aktuale ekonomike në dispozicion. Burimet e informacionit të përdorur dhe të shqyrtuar për besueshmërinë janë të rëndësishme në shqyrtimin e të dhënave.

Analizoni konkurrencën. Listoni konkurrentët brenda zonave të tregut që do shërbehet, ato nga jashtë që mund të ndikojë në tregje dhe çdo konkurrencë potenciale. Jepni perceptimin tuaj dhe analizën e strategjive të tregut të tyre dhe rezultatet e pritshme në lidhje me fuqinë relative, aksionet e tregut dhe çmimet.

Shpjegoni strategjitë që ju do t'i ndiqni për të tërhequr një përqindje të secilit produkt në treg dhe rezultatet e pritshme për t'u arritur.

6.3. Planet dhe objektivat

Shqyrtimi i supozimeve kryesore të planifikimit, të përdorura në analizën e tregut dhe në përcaktimin e planeve dhe objektivave për bankën e propozuar. Përfshij të paktën këto si në vijim: rritjen e depozitave, rritjen e kredisë, rritjen e pjesëmarrjes në treg, normat e interesit, koston e fondeve, koston e tjera, konkurrencën, etj. në varësi të rrethanave, planifikimet e supozuara mund të dallojnë për tregje të ndryshme që do të shërbehen.

6.4. Struktura e mjeteve dhe e detyrimeve

Projeksionet duhet të tregojnë pasurinë e pritshme dhe llojet e detyrimeve, vëllimi për çdo lloj shërbimi, investimet në mjete themelore dhe menaxhmentin dhe shpërblimet e personelit. Projeksionet duhet të bazohen në planifikimin e supozuar, të cilat duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit, analizës së tregut dhe strategjitë e diskutuara më sipër. Formatet e kërkuara për këto projeksione janë dhënë në faqen e internetit të BQK-së: www.bqk-kos.org tek Aplikacionet - Shtojca D - Pro forma e projeksioneve financiare. Përfshij hollësitë specifike të mjeteve themelore dhe koston/shpenzimet përkatëse.

Diskutoni përparësitë dhe mangësitë e propozuara të llojeve të mjeteve/detyrimeve, duke përfshirë një analizë neto të margjinave të interesit dhe çdo veprim që do të merret për të zvogëluar rreziqet kryesore me anë të teknikave dhe sistemeve të përshtatshme për menaxhimin e fondeve.

6.5. Plani i kapitalizmit/neto vlera

Diskutoni formulën apo bazën e përdorur për të arritur strukturën e kapitalit të propozuar dhe një shpjegim se përse organizatorët besojnë se shuma e propozuar është e mjaftueshme në vazhden e faktorëve të tregut, strategjive dhe shpenzimeve. Pritet që organizatorët të mbledhin një shumë të mjaftueshme për të konkurruar në mënyrë efektive në zonën e tregut dhe në mënyrë adekuate të mbështesë operacionet e planifikuara përveç të gjitha shpenzimeve organizative. BQK-ja mund të kërkojë

një shumë më të lartë për të mbajtur mjaftueshmërinë e kapitalit për të mbështetur operacionet e parashikuara deri në fund të vitit të tretë të bankës ose ndryshe siç kërkohet nga Departamenti i Mbikëqyrjes Bankare.

Fillimisht diskutoni planet për mbledhjen e kapitalit dhe për të financuar rritjen brenda pesë viteve të para. Shpjegoni se si planet tuaja do të mbajnë bankën në përputhje me udhëzimet e BQK-së për mjaftueshmërinë e kapitalit, posaçërisht duke ju adresuar udhëzimeve për pajtueshmërinë e kapitalit bazuar në rrezik dhe raportit të levës.

Aplikacioni duhet të përfshijë planin për kapitalin e bazuar në rrezik duke detajuar ndaras elementet e Klasës 1 dhe Klasës 2 të kapitalit në bazë të formës për projeksione. Përfshij një përlllogaritje të raportit të kapitalit të bazuar në rrezik dhe raportit të levës. Raporti i levës është i barabartë me totalin e ekuitetit pjesëtuar me mjetet totale. Projektionet duhet të bëhen për tre vitet e para të aktivitetit. "Raporti mbi mjaftueshmërinë e kapitalit të bankave" e përfshirë në shtojcën D - Forma e projeksioneve financiare duhet të plotësohet dhe dorëzohet me aplikacionin tuaj.

Diskutoni numrin e aksioneve që do të autorizohen, numrin e aksioneve që do të lëshohen, vlera nominale për aksion dhe çmimi i shitjes për aksion.

7. BQK-ja përgjithësisht kundërshton kapitalin e ngritur nga borxhi në një banke të re

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës mund të kërkojë informacion shtesë në varësi të përshtatshmërisë së materialeve origjinale të dorëzuara dhe/ose në rezultatet e çdo rishikimi apo ekzaminimi.

8. Informacionet e projeksioneve financiare

Organizatorët e një banke duhet të përgatitin projektionet e bilancit të gjendjes, pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve, mjaftueshmërinë e kapitalit me mjetet e rrezikuara duke përdorur format e dhënë në Shtojcën D – forma e projeksioneve financiare. Grupi organizativ duhet të dorëzojnë deklaratat që reflektojnë projektionet e mjeteve, detyrimeve dhe të kapitalit për numrin e viteve që janë parashikuara që të arrihet profitabiliteti, megjithatë, duhet të raportohet një minimum prej tre vjetësh.